



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Panorama e Artit Panhispanik

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore/ seminare

Viti / Semestri : Viti II, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Hispanik

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kjo lëndë i ofron studentit një përmbledhje të historisë së artit në Spanjë dhe Amerikën Latine duke e studiuar sipas periudhave të ndryshme kohore, që nga arti i antikitetit deri në shekullin XXI.

Në të analizohen disa nga veprat më të rëndësishme të artit panhispanik dhe vendi që ato zenë në artin universal. Përzierja e kulturave të ndryshme ndër shekuj dhe pasqyrimi i tyre në art përbëjnë një nga karakteristikat kryesore dalluese të artit hispanik.

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet të jetë i aftë të:

1. Të njohë format e ndryshme të artit si piktura, skulptura, arkitektura në Spanjë dhe Amerikën Latine dhe ndikimet e kulturave të popullsisë të tjera
2. Të njohë historinë e zhvillimit të artit në këto vende.

Rezultate të pritshme:

1. Të kuptojë dhe analizojë ndikimin e zhvillimeve historike, ekonomike dhe shoqërore në art
2. Të zgjerojë njohuritë gjuhësore sipas terminologjisë së kësaj fushe studimi.
3. Të rrisë aftësitë komunikative përmes leximit, të folurit dhe të shkruarit të teksteve të ndryshme të fushës
4. Të përmirësojë aftësitë investiguese dhe argumentuese përmes kërkimit të informacionit, përgatitjes dhe prezantimit të projekteve në lidhje me lëndën.
5. Të zhvillojë punë të pavarur individuale dhe në grup